VENDIM
Nr. 637, datë 31.7.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 372, DATË 3.5.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MË 23 QERSHOR 2013"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 372, datë 3.5.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të vitit 2013, t'i shtohet një fond prej 521 000 000 (pesëqind e njëzet e një milionë) lekësh, nga i cili 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekë, për shpenzime personeli, për kryerjen e pagesave për komisionerët e KZAZ-ve, qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit; 436 000 000 (katërqind e tridhjetë e gjashtë milionë) lekë, për shpenzime operative, për projektet SEN dhe SEV, dhe 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për shpenzime për investime.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha